



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:112395
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05592880

Ac.nr.816/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. K. e S., me seli në Prishtinë, Rr. L. e P. p.n., të cilën e përfaqëson, Kompania “D. C. A.”- D.C.A., me seli në Prishtinë, me përfaqësuesin e autorizuar A. A., kundër të paditurit, Z. B., nga fshati R., Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson G.Q. Kelmendi, avokat nga Istogu, sipas autorizimit nga Zyra për Ndhim Juridike Falas, objekti i kontestit rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.208/19, datë 20.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses B. K. e S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.208/19, datë 20.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.208/19, datë 20.12.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: “REFUZOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesë padia e paditëses: B. K. e S. me seli në Prishtinë, rr. L. e P., p.n., me çka ka kërkuar që të: DETYROHET i padituri, Z. B., nga fshati R., Komuna e Istogut, që paditëses, B. K. e S. me seli në Prishtinë, në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt. 08.07.2016, t’i paguaj shumën në lartësi prej, 7,667.00 euro , dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes se kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, si dhe ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës të cilat do ti caktoj gjykata, në afat prej 15 dhiteshe pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. II. Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me pretendimet se gjykata e shkallës së parë deri tek ky aktgjykim i ankimuar ka ardhur duke mos e vërtetuar qartë gjendjen faktike ashtu që e njëjta ia ka falur besimin ekspertizës së komunikacionit rrugor të datës 10.03.2021 ashtu që të njëjtën e ka mbivlerësuar si provë. Ka propozuar që të aprovohet ankesa dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që lënda të kthehet në rigjykim.

E paditura ndaj kësaj ankese, ka paraqitur përgjigje përmes së cilës si ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditëses, me theksimet se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë në bazë të provave, dëshmime, ekspertizës dhe fjalëve të palëve në procedurë dhe se aktgjykimi është meritore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, B. K. e S. me seli në Prishtinë, me datë 27.05.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit Z. B., përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensojë shumën prej 7,667.00€ në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 08.07.2016 në Istog, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe t'ia paguajë shpenzimet gjyqësore të procedurës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.208/19, datë 20.12.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për të vërtetuar këtë gjendje faktike gjykata mori për bazë dhe ja fali besimin në tërësi ekspertizës së komunikacionit rrugor të dt.10.03.2021 e nxjerre si provë në këtë procedurë e punuar nga eksperti i komunikacionit rrugor Dr.sc. V. B., nga leximi i ekspertizës në fjalë si dhe sqarimeve të dhëna nga ana e ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.12.201, gjykata në përfundimet e dhëna të kësaj ekspertize ka vërtetuar rrethanat se duke u bazuar në materialet në lëndë, analizës dhe konstatimit e mësipërm, mendojmë se aksidenti është shkaktuar nga tejkalimi i pasigurt i automjetit NN. Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera shkrësor në lëndë si dhe pretendimet tjera të palëve në procedurë respektivisht të autorizuarit të palës paditëse dhe të autorizuarit të të paditurit edhe sa i përket propozimeve për dëgjimin e dëshmitarit F. T. dhe dëgjimin e të paditurit Z. B. në cilësinë e palës, këto propozim gjykata i ka refuzuar si propozim të pa arsyetuara dhe të pa nevojshëm sepse në këtë çështje janë nxjerr prova materiale dhe është marr edhe prova me ekspertizë të komunikacionit nga ana e ekspertit përkatës, prandaj propozimet tjera janë refuzuar si të pa arsyeshëm respektivisht të pa nevojshme, gjykata nuk u lëshua në arsyeshmërinë e tyre, sepse konsideroj se nuk do të ishim me ndikim për një vendim me ndryshe.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat ligjore nga neni 154 i Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve e lidhur me nenin 7 dhe 319 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket mos vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadiës së paditëses. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës dhe provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se paditësja me asnjë provë nuk e ka provuar faktin se me të vërtetë këtu i padituri është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 08.06.2016. Në anën tjetër, referuar shkresave të lëndës, përkatësisht nga ekspertiza e komunikacionit e ekspertit Dr.sc. V. B., të cilën ekspertizë pala ankuese gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe me anë të ankesës e ka kundërshtuar me theksimet se e njëjta është bazuar në vetëm pretendimet e të paditurit, mirëpo e njëjta nuk ka propozuar ekspertizë të re për të provuar të kundërtën. Nga dëgjimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Dr.sc. V. B. në seancën e datës 17.12.2021, me të drejtë është provuar se ekspertiza e të njëjtit është profesionale, e hartuar në bazë të shkresave të lëndës dhe provave që i njëjti i ka pasur në dispozicion siç janë raporti policor, raporti i zgjeruar, skica e vendit të ngjarjes dhe fotot, konstatohet fakti se në rastin konkret aksidenti ka ardhur si pasojë e rrokullisjes së traktorit për shkak të lëvizjes në pjerrtësi jashtë rruge, e cila ka ardhur si pasojë e pengesës së paraqitur dhe si përfundim aksidenti i shkaktuar ka ardhur si pasojë e tejkalimit të pasigurt nga automjeti NN. Nga të gjeturat e kësaj ekspertize rezulton se i padituri nuk është shkaktar i aksidentit, si dhe nuk ka kontribuar në shkaktimin e tij, po ashtu mendimi i dhënë i ekspertit, është në përputhje me kallëzimin penal të datës 15.07.2016 të paraqitur ndaj NN. Prandaj me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë se kërkesëpadia e paditëses për rimbursimin e dëmit në raport me të paditurin është e pathemeltë.

Pretendimi ankimor që tenton të paraqes ekspertizën e komunikacionit si jo profesionale, mbi pretendimet se nuk është vërtetuar është kontributi eventual i pjesëmarrësve në aksident, nuk ka dëshmitar të vendit të ngjarjes, nuk ka pikë të goditjes, janë të pa bazuara. Ky vlerësim vije nga fakti se së pari pika e goditjes nuk është përmendur përgjatë procedurës gjyqësore, po ashtu nga asnjë mjet provues tjetër që më pas eksperti do të kishte konstatuar atë, eksperti ka paraqitur se aksidenti nuk ka ardhur si pasojë e goditjes, por nga veprimet e pasigurta të shakatarit NN, rrjedhimisht pasqyrimi si në ekspertizë del të jetë i saktë. Së dyti, fakti se ekspertiza nuk është bazuar në dëshmitarë të vendit të ngjarjes, pala

në procedurë nuk ka propozuar ndonjë dëshmitar, i cili do të paraqiste të dhëna për aksidentin, që më pas eksperti i komunikacionit do të analizonte atë deklaram dhe në seancë do të ofronte mendim plotësues. Gjithashtu është i rëndësishëm fakti se cili është ai dëshmitar që pala e paditur ka parasysht, dhe që do të jepte këto të dhëna. Për sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë është udhëhequr nga parimi i shqyrtimit të të provuarit, ashtu që mbi bazën e materialit provues të ofruar nga ndërgjyqësit, të bëjë çmuarjen e tyre dhe të vendos për kërkesëpadinë. Në shkresa të lëndës ekziston ekspertiza e nxjerrë e cila është analizuar, kurse në seancat e mbajtura në shkallë të parë, nuk mund të gjendet ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, apo ndonjë pretendim i bazuar që ekspertizën e nxjerrë do ta bënte si jo profesionale. Prandaj gjykata me të drejtë ka vendosur duke arritur në përfundim në përputhje me nenin 319 par. 1 i LPK-së, sipas të cilit “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Përmes kësaj norme është rregulluar parimi i shqyrtimit që është themelor në procedurë kontestimore, ashtu që gjykata do të vendos mbi bazë të materialit procedural provues, që kanë ofruar palët në procedurë.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ashtu që drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore nga neni 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se ‘*Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*’. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësise për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore e që në rastin konkret një përgjegjësi e tillë për rimbursim dëmi nuk bie mbi palën e paditur pasi që ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe veprimit të paditurit mungon lidhja kauzale ngase ashtu siç u elaborua më lartë dëmi është shkaktuar nga tejkalimit i pasigurt nga automjeti NN.

Në analizim të pretendimeve ankimore, Gjukata e Apelit nuk ka gjetur ndonjë vlerësim tjetër, për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjukatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
AC.nr.816/2022, datë 05.04.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli